

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm me qira të ndërtesës së ish Çerdhes së fëmijëve e cila gjendet në rr. "Ismet Jashari-Kumanova", Shoqatës së Biznesmenëve dhe Zejtarëve të Prizrenit "Esnaf", dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës- Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Biznesmenëve dhe Zejtarëve të Prizrenit "Esnaf", për dhënien në shfrytëzim të një ndërtese (hapësire) në pronësi të Komunës, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve të tyre. Kështu që, Shoqatës së Biznesmenëve dhe Zejtarëve të Prizrenit "Esnaf" në Prizren, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm me qira, ndërtesa e ish Çerdhes së fëmijëve e cila gjendet në rr. "Ismet Jashari-Kumanova" afër ShFMU "Mustafa Bakija", dhe atë me qira mujore prej 1 €.

II. Afati i shfrytëzimit do të jetë deri me 31.12.2014 me mundësi vazhdimi.

III. Obligohet Drejtoria e Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike që të përpilojë kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të ndërtesës (hapësirës) së lartcekur sipas nenit I dhe II të këtij konkluzioni.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Shoqata e lartcekur, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e shpalljes së tenderit për shumëzimin e CD-ve të filmit promociional "Mirë se vini në Prizren" dhe të disa spoteve televizive, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 30.8.2013 për lejimin e shumëzimit të 1000 CD-ve të filmit promociional "Mirë se vini në Prizren" dhe të spoteve televizive për promovimin e turizmit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë për lejin e shpalljes së tenderit për qasjen në internet të objekteve të shëndetësisë primare, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 6.9.2013 për lejin e qasjes në internet të objekteve të shëndetësisë primare, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mëja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-22659

Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për disa klube sportive për vitin 2013, kryetari i Komunës më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare të disa klube sportive për vitin 2013 lidhur me ushtrimin e aktiviteteve të tyre. Kështu që klubet sportive që përkrahen financiarisht janë:

1. Klubi i hendbollit "Prizreni" F - 3000 €,
2. Klubi i basketbollit "Bashkimi" F... 1500 €,
3. Klubi i hendbollit "Prizren" M -.....1500 €,
4. Klubi i çiklistik "Prizreni".....1500 €,
5. Klubi i mundjes "Prizreni".....1500 €,
6. Klubi i atletikës "Prizreni".....1500 €,
7. Klubi i boksit "Prizreni".....1000 €,
8. Klubi i xhudos "Prizreni".....1000 €,
9. Klubi i tenisit "Prizreni".....1000 €,
10. Klubi i shahut "Zhupa"..... 500 €,
11. Klubi i pingpongut "Prizreni".....500 €,
12. Klubi i pingpongut "Elif 19".....500 €,
13. Klubi i karatesë "Prizreni".....500 €, dhe
14. Klubi i karatesë "Elmedina".....500 €.

Gjithsej shuma e përgjithshme e mjeteve që lejohet në emër të përkrahjes financiare për klubet sportive të lartcekura është 16.000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22663
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje financiare për Teatrin Profesionist të Prizrenit, kryetari i Komunës më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 4.9.2013, për mbështetje financiare për Teatrin Profesionist të Prizrenit, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve lidhur me realizimin e projekteve teatrale, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 5000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkiivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22669
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për formimin e Komisionit për hartimin e draft statutit të Teatrit Profesionist të Qytetit, kryetari i Komunës, me 10 shtator 2013, mori këtë

AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për hartimin e draft statutit të Teatrit Profesionist të Qytetit. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Fetah Paçarizi, kryetari i komisionit,
- b. Urim Ukimeri, dhe
- c. Sefer Avduti, për anëtar.

II. Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do ta hartoj draft statutin e Teatrit Profesionist të Qytetit duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe pas hartimit të draft statutit të lartcekur, të procedojë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

III. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, si dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, të emëruarit dhe Arkivi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22672
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës për dhënien e pëlqimit për dërgimin e instrumentit gjeodezik (total stacion) për rektifikim në Zvicër, kryetari i Komunës më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

I jepet pëlqimi Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës, për dërgimin e instrumentit gjeodezik (total stacion) për rektifikim në Zvicër.

Neni 2

Dërgimin e instrumentit gjeodezik TS nr. 765271 (total stacion) për rektifikim në Zvicër, do ta bëjë firma e specializuar DWH nga Prishtina.

Neni 3

Obligohet firma DWH e cila e ka marrë për obligim dërgimin e instrumentit gjeodezik për rektifikim në Zvicër, që të njoftoj zyrtarisht organet kompetente të Komunës së Prizrenit, lidhur me çmimin (koston) e ofruar për rektifikim në mënyrë që Komuna të merr vendim lidhur me procedurat e mëtutjeshme.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Firma DWH, si dhe arkivi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22677
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Çështje Gjinore, për lejimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve operationale të Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren, kryetari i Komunës, më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Çështje Gjinore, për lejimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve operationale (rryma, uji, higjiena, mirëmbajtja) të Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren, kështu që për mbulimin e shpenzimeve të lartcekura, lejohen mjetet e nevojshme financiare për pagesë të këtyre shpenzimeve edhe për gjashtëmujorin e dytë të këtij viti.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe se pagesa do të bëhet pas parashtrimit të faturave.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22682
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Çështje Gjinore për lejin e mjeteve për mbështetje financiare për Shoqatën e të Verbërve, kryetari i Komunës, më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Çështje Gjinore, për lejin e mjeteve për mbështetje financiare për Shoqatën e të Verbërve, lidhur për organizimin e kursit të gjuhës angleze, në të cilin kurs do të mësojnë gjuhën angleze studentët e verbër si dhe familjar që kanë fëmijë të verbër, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në lartësi 800€.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4*

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Shoqata e të Verbërve si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 10.9.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve në fshatin Landovicë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.9.2013, për lejimin e ndërtimit me elemente të betonit të disa rrugëve në fshatin Landovicë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 10.9.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës Sërbicë e Epërme-Smaq, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.9.2013, për lejimin e ndërtimit me asfalt të rrugës Sërbicë e Epërme-Smaq, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mita



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 10.9.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për rehabilitimin e rrugës në fshatin Manastiricë, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.9.2013, për lejimin e rehabilitimit me asfalt të rrugës në fshatin Manastiricë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 10.9.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e rrugës në fshatin Korishë-lagjja Xhaferaj, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.9.2013, për lejimin e ndërtimit të rrugës në fshatin Korishë-lagjja Xhaferaj, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 10.9.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve në lagjen Arbana, me participim, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.9.2013, për lejimin e ndërtimit të disa rrugëve në lagjen Arbana, me elemente të betonit, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 10.9.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejin e shpalljes së tenderit për rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit në rrugën për në fshatin Leskovec, me participim, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 10.9.2013, për lejin e rehabilitimit të sistemit të ujësjellësit në rrugën për në fshatin Leskovec, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19906
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 10.9.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente të betonit të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve, me participim, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 9.9.2013, për lejimin e ndërtimit me elemente të betonit të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve, me participim, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugës "Flamuri",
2. Rrugës "Agim Bajrami",
3. Rrugës "Nazim Lushaj", dhe
4. Rrugëve lokale në fshatin Nashec.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mulla



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-
Më 10.9.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës-Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, për dhënien në shfrytëzim të një zyre në pronësi të Komunës Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, dhe mori këtë

KONKLUZION

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës -Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së në Prizren, për dhënien në shfrytëzim të një zyre në pronësi të Komunës kësaj shoqate, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve të tyre. Kështu që, i jepen në shfrytëzim të përkohshëm një zyre në objektin e ish ndërtesës së Kadastrës dhe atë me qira mujore prej 1 €.

II. Obligohet Drejtoria e Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike që të përpilojë kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të lokalit-zyrës së lartcekur sipas nenit I të këtij konkluzioni.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës- Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës- Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Maja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-22689
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Mirije Ponikut nga Prizreni, për mbështetje me mjete financiare për furnizimi me gjëra ushqimore, kryetari i Komunës më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet kërkesa e Mirije Ponikut nga Prizreni për mbështetje me mjete financiare, me qëllim të furnizimit me gjëra ushqimore-miell 200 kg, sheqer 50 kg, vaj 50 l, fasule 10 kg, oriz 5 kg, krip 10 kg., kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për furnizim me gjërat e lartcekura.

Furnizimi do të bëhet te operatori ekonomik, i cili bën furnizimin e Komunës me gjëra ushqimore dhe higjienike.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës, Sektori i Furnizimit i KK-së, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Sektori i Furnizimit i KK-së, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-zyrtar
Më 10.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare të manifestimit - "15 Shtatori-Dita e Dëshmorëve të Komunës së Prizrenit", kryetari i Komunës, më 10 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për përkrahje financiare të manifestimit "15 Shtatori-Dita e Dëshmorëve të Komunës së Prizrenit", kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për organizimin dhe shënimin e këtij manifestimi.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Maja

